<p>lejuara dhe të autorizuar për të vepruar në Kosovë.</p> <p>1.3. interesi nga instrumente financiare i lëshuar apo garantuar nga Autoriteti Publik i Kosovës, i paguar për tatimpaguesin rezident apo jo rezident.</p> <p>1.4. të ardhurat e Bashkësive fetare sipas Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë.</p> <p>1.5. të ardhurat e kontraktorëve primar ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-it dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore, me kusht që ata drejtpërdrejt të jenë të angazhuar në projekte dhe programe të organizatave të cekura më lartë.</p> <p>1.6. të ardhurat e kontraktorëve primar ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, Agjencitë e Specializuara të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në mbështetje</p>	<p>financial institutions operating in Kosovo.</p> <p>1.3 Interest on financial instruments which are issued, or guaranteed, by a public authority of Kosovo paid out to resident or non-resident taxpayers.</p> <p>1.4 Income of religious communities under the Law on Religious Freedom in Kosovo.</p> <p>1.5 Income of a prime contractor or a subcontractor, other than a local person, generated from contracts for the supply of goods or services to the United Nations, the Specialized Agencies of the United Nations, KFOR and the International Atomic Energy Agency under the condition that they are directly engaged in projects and programs of the organizations mentioned above.</p> <p>1.6 Income of a prime contractor or a subcontractor but other than a local person, generated from contracts with foreign governments, their organs and agencies, the European Union, the Specialized Agencies of the European Union; the World Bank, the International Monetary Fund and international inter-governmental organizations for the supply of goods or</p>	<p>institucija koje su dozvoljene i ovlašćene da rade na Kosovu;</p> <p>1.3. kamata od finansijskih instrumenata koji su izdati ili garantovani od javnog organa Kosova, isplaćen rezidentu ili nerezidentu;</p> <p>1.4 prihodi verskih zajednica prema Zakonu o verskim slobodama na Kosovu;</p> <p>1.5. prihodi glavnih ugovarača ili podugovarača, osim domaćih lica, koja su osnovana ugovorom o nabavci robe i usluga za Ujedinjene nacije, specijalizovane agencije Ujedinjenih nacija, KFOR, i Međunarodnu agenciji za atomsku energiju, pod uslovom da su oni neposredno angazovani u projekte i programe gore navedenih organizacija.</p> <p>1.6. prihodi glavnih ugovarača ili podugovarača, osim domaćih lica, koja su osnovana ugovorom sa stranim vladama, njihovim organima i agencijama, specijalizovanim agencijama Evropske Unije, Svetskom Bankom, Međunarodnim monetarnim fondom i međunarodnim međuvladinim organizacijama za nabavku robe i usluga u podršci projekata i programa za Kosovo.</p>
---	--	---

<p>të projekteve dhe programeve për Kosovën.</p> <p>1.7. të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.</p> <p>2. Organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>3. Pushimet tatimore dhe lehtësirat e tjera të veçanta për bizneset që paraqesin projekte dhe investime të reja, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>services in support of programs and projects for Kosovo.</p> <p>1.7 Income received from grants, subsidies and donations in accordance with the rules and conditions for benefiting.</p> <p>2. The international inter-governmental organizations shall be determined in a sub-legal act issued by the Minister</p> <p>3. Tax breaks and other special facilities for businesses presenting new projects and investments are defined by sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>1.7. prihodi od grantova, subvencija i donacija, u skladu sa pravilima i uslovima dobijanja.</p> <p>2. Međuvladine međunarodne organizacije utvrđuju se podzakonskim aktom kojeg izdaje ministar.</p> <p>3. Poreska oslobođenja i druge posebne olakšice za biznise koji predstavljaju nove projekte i investicije, utvrđuju se podzakonskim aktom kojeg izdaje ministar.</p>
<p>KAPITULLI III- SHPENZIMET</p> <p>Neni 9 Shpenzimet e palejueshme</p> <p>1. Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme, nuk lejohet zbritje për:</p> <p>1.1. shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;</p> <p>1.2. koston e përmirësimit, renovimit dhe rikonstruksionit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar, nuk do të njihen shpenzim i periudhës, por</p>	<p>CHAPTER III - EXPENDITURE</p> <p>Article 9 Disallowed Expenses</p> <p>1. While determining taxable income, the following , the following expenses are disallowed:</p> <p>1.1 Cost of acquisition and improvement of land</p> <p>1.2. Cost of improvement, renovation and reconstruction of assets that are capitalized and depreciated shall not be recognized as an expenditure of this</p>	<p>POGLAVLJE III- TROŠKOVI</p> <p>Član 9 Nepriзнati troškovi</p> <p>1. Pri utvrđivanju oporezivih prihoda, ne priznaju se sledeći troškovi:</p> <p>1.1.troškovi sticanja i poboljšanja zemljišta;</p> <p>1.2. troškovi poboljšanja, renoviranja i rekonstrukcije sredstava koja su kapitalizovana i obezvređena, neće se priznati kao troškovi perioda, nego biće</p>

<p>do të trajtohen në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;</p> <p>1.3. gjobat, ndëshkimet dhe interesi që shqiptohen nga ndonjë autoritet publik dhe, shpenzimet që lidhet me ato;</p> <p>1.4. tatimin në të ardhura i paguar ose i lindur për periudhën tatimore aktuale ose të mëparshme dhe çdo interes ose ndëshkim i krijuar për pagesë me vonesë të tij;</p> <p>1.5. tatimi mbi vlerën e shtuar, për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm në bazë të legjislacionit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;</p> <p>1.6. humbjen tatimore nga transaksionet ndërmjet personave të lidhur, me përjashtim të rasteve kur është në përputhje me vlerën e hapur të tregut;</p> <p>1.7. kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar sipas legjislacionit përkatës për pensionet në Kosovë.</p> <p>1.8. shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit, të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqësimit;</p>	<p>period, but shall rather be handled in accordance with Article 19 of this Law;</p> <p>1.3 Fines, penalties, costs interest imposed by a public authority and expenditures related to them;</p> <p>1.4 Income taxes paid or accrued for the current or previous tax period and any interest or late penalty incurred for late payment of it;</p> <p>1.5 Value added tax for which the taxpayer claims a rebate or credit for input tax under legislation on Value Added Tax; and</p> <p>1.6 tax loss from transactions between related persons, with the exception of cases when in compliance with the open market value;</p> <p>1.7 Pension contributions above the maximum amount allowed by the relevant Kosovo pension Law.</p> <p>1.8. expenses on gifts, except those containing the name and logo of the business organization, which fall under representation expenses</p>	<p>tretirani u skladu sa članom 19. ovog zakona;</p> <p>1.3.novčane kazne, kazne i kamata koja se izrekne od bilo kog javnog organa, troškovi i koji se odnose na njih;</p> <p>1.4.porez na dohodak isplaćen ili ostvaren u trenutnom ili prethodnom poreskom periodu i svaka ostvarena kamata ili kazna za uplatu zbog kašnjenja;</p> <p>1.5.porez na dodatu vrednost za koji poreski obveznik potražuje povraćaj ili kredit povraćaj poreza prema zakonodavstvu o poreza na dodanu vrednost;</p> <p>1.6.poreski gubici od transakcija između povezanih lica, izuzev slučajeva kada je u skladu sa otvorenim tržišnom vrednošću;</p> <p>1.7. penzijski doprinosi na maksimalan dozvoljeni iznos, koji je utvrđen relevantnim zakonodavstvom o penzijama na Kosovu.</p> <p>1.8.troškovi za poklone, osim onih koji su sa nazivom i logom poslovanja, koji spadaju u troškove reprezentacije;</p>
---	--	--

<p>1.9. humbjet në peshë specifike apo substancë, dëmtimet, mbetjet, tepricat, shkatërrimet apo thyerjet gjatë prodhimit, transportit, magazinimit dhe ekspozimit, përtej normave të përcaktuara me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;</p> <p>1.10. përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur organizohet nga biznesi;</p> <p>1.11. shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jorezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit;</p> <p>1.12. shpenzimet e mbuluara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;</p> <p>1.13. shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion, përveç nëse kanë ndodhur në lidhje me afarizmin e tatimpaguesit që ofron aktivitetet për dëfrim dhe rekreacion.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Shpenzimet e lejueshme</p> <p>1. Në varësi të kufizimeve të këtij ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm</p>	<p>1.9. losses in specific weight or material, damages, remains, surpluses, destruction or breakings during production, transport, storing, and displaying, beyond the norms set out with relevant legal and sub-legal acts.</p> <p>1.10. gains in kind such as meals and transport, except in cases when organized by the business organization;</p> <p>1.11. expenses for renting apartments, used for accommodation of resident and non-resident employees, depending from the employment or service contract;</p> <p>1.12. expenses covered by grants, subsidies and donations, in accordance with the rules and conditions of their benefiting;</p> <p>1.13. expenses for entertainment and recreation, except if they occurred as a result of the taxpayer's business of providing entertainment and recreation activities.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Eligible expenses</p> <p>1. Subject to the limitations in this Law, in determining taxable income, a taxpayer shall be allowed a deduction from gross income expenses paid or incurred during</p>	<p>1.9.gubici specifične ili supstancijalne težine, oštećenja, otpad, viškovi, uništavanje ili lomljenje tokom proizvodnje, prevoza, skladištenja ili izlaganja, izvan normi koje su utvrđene posebnim zakonskim i podzakonskim aktima;</p> <p>1.10.dohodak u naturi u obliku obroka ili prevoza, osim slučajeva kada se organizuje od poslovanja;</p> <p>1.11.troškovi zakupa stanova, koji služe za smeštaj i noćenje rezidentnih i nerezidentnih zaposlenih, bez obzira na uslove ugovora o radu ili ugovora o uslugama;</p> <p>1.12.troškovi koje pokrivaju grantovi, subvencije ili donacije, u skladu sa pravilima i uslovima dobijanja;</p> <p>1.13.troškovi zabave i rekreacije, osim ako su ostvareni u vezi sa poslovnim aktivnostima poreskog obveznika koji pruža aktivnosti zabave i rekreacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Priznati troškovi</p> <p>1. U zavisnosti od ograničenja ovog zakona, u utvrđivanju oporezivih prihoda, poreskom obavezniku priznaju se odbijanja od bruto prihoda, plaćenih ili</p>
--	---	--

<p>gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit.</p> <p>2. Shpenzimet edukativo-arsimore të paguara nga një punëdhënës në një institucion edukativo-arsimor për një të punësuar, janë të lejueshme në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla janë paguar, me kusht që:</p> <p>2.1. shpenzimet edukativo-arsimore të jenë paguar drejtpërdrejtë në institucionin edukativo-arsimor;</p> <p>2.2. institucioni edukativo-arsimor është i pranuar me legjislacion përkatës në fuqi në Kosovë;</p> <p>2.3. edukim-arsimimi lidhet me pozitën e të punësuarit dhe nuk e kualifikon atë të punësuar për punë në një profesion tjetër; dhe</p> <p>2.4. i punësuar mbetet në punësim të punëdhënësi pas përfundimit të edukimit-arsimit, për të cilin shpenzimet janë paguar nga punëdhënësi për një periudhë kohore të specifikuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>the tax period wholly and exclusively in connection with its economic activities, including premiums paid on the health insurance on behalf of an employee and those dependents eligible to be included in the policy of the employee.</p> <p>2. Educational expenses paid by an employer to an educational institution for an employee shall be allowable in full in the year in which such expenses are paid, provided that:</p> <p>2.1. education expenses are paid directly to the educational institution;</p> <p>2.2. the educational institution is recognized by Law in force in Kosovo;</p> <p>2.3. the education is relevant to the employee's position and does not qualify that employee for work in a different occupation; and</p> <p>2.4. the employee remains in employment of the employer after completion of education for which the expenses were paid by the employer for a period of time to be specified in a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>ostvarenih tokom poreskog perioda, u potpunosti i isključivo svojom privrednom delatnošću, uključujući i premije za zdravstveno osiguranje, isplaćene u interesu zaposlenog i zavisne premije koja treba da budu obuhvaćene u polisi zaposlenih.</p> <p>2. Edukativno-obrazovni troškovi, isplaćeni od strane poslodavca u jednoj edukativnoj-obrazovnoj ustanovi za jednog zaposlenog, priznati su u potpunosti u godini u kojoj su plaćeni takvi troškovi, pod uslovom da:</p> <p>2.1. su edukativni-obrazovni troškovi isplaćeni direktno edukativno-obrazovnoj ustanovi;</p> <p>2.2. edukativno-obrazovna ustanova je priznata relevantnim važećim zakonodavstvom na Kosovu;</p> <p>2.3. edukacija-obrazovanje odnosi se na poziciju zaposlenog i ne kvalifikuje zaposlenog za rad u nekoj drugoj profesiji ; i</p> <p>2.4. zaposleni ostaje zaposlen kod poslodavca nakon završetka edukacije-obrazovanja za kojeg su troškovi isplaćeni za jedan vremenski period, koji je utvrđen podzakonskim aktom kojeg izdaje ministar.</p>
--	---	---

<p>3. Shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, që lidhen me punën, lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.</p> <p>4. Nëse një tatimpagues, ndryshe nga një tatimpagues i angazhuar në afarizëm për dhënie me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, zgjedh të mos mbajë regjistrime të shpenzimeve aktuale të paguara apo të lindura në aktivitetin e qirasë, tatimpaguesit të tillë i lejohet një zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të qirave të pranuar me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimeve tjera të paguara apo të krijuara gjatë realizimit të qirasë.</p> <p>5. Nuk do të lejohet zbritje për çdo shpenzim të rrjedhë bazuar në një obligim të mbajtjes në burim, përveç nëse shpenzimet e tilla të jenë paguar në ose para 31 marsit të periudhës pasuese tatimore. Çdo shpenzim i palejuar nga ky paragraf është i zbritshëm në periudhën tatimore në të cilën në të vërtetë është paguar.</p> <p>6. Ministri nxjerr akt nënligjor për shpenzimet e dokumentuara të cilat rrjedhin nga vlerësimet dhe rivlerësimet doganore.</p>	<p>3. Training expenses paid by an employer for an employee relating to the job, shall be allowed throughout the year within which such training expenditures have occurred.</p> <p>4. If a taxpayer, other than a taxpayer engaged in the business of leasing movable or immovable property, opts to not maintain records of actual expenses paid or incurred in the rental activity, such taxpayer shall be allowed a deduction from gross rental income in an amount equal to ten percent (10%) of the rents received in order to account for depreciation allowances and cover the costs of repairs, collection charges, and other expenses paid or incurred in generating the rental income.</p> <p>5. No deduction shall be allowed for any accrued expense based on a withholding obligation unless such expense is paid on or before 31 March of the subsequent tax period. Any expense not allowed by this paragraph shall be deductible in the tax period in which it is actually paid.</p> <p>6. The Minister shall issue a sub legal act on documented expenditures incurred from custom assessments and reassessments</p>	<p>3. Troškovi obuke, isplaćeni od jednog poslodavca za jednog zaposlenog, koji se odnose na rad, priznaju se u potpunosti u godini u kojoj su ti troškovi nastali.</p> <p>4. Ako poreski obaveznik, za razliku od poreskog obaveznika koji obavlja posao davanja pod zakup pokretne i nepokretne imovine, bira da ne vodi evidenciju aktuelnih isplaćenih troškova ili nastalih iz aktivnosti zakupa, poreskom obavezniku biće priznato odbijanje od bruto prihoda od zakupa jednak iznosu od deset odsto 10% primljenog zakupa u cilju pokrivanja troškova popravke, naplate i drugih troškova koji su isplaćeni ili koji su nastali tokom realizacije zakupa.</p> <p>5. Neće biti priznato nikakvo odbijanje za sve tekuće troškove na osnovu obaveze poreza po odbitku, osim ako su takvi troškovi isplaćeni ranije ili 31. marta sledećeg poreskog perioda. Bilo koji nepriznati troškovi iz ovog stava biće odbijeni u poreskom periodu u kojoj su zapravo isplaćeni.</p> <p>6. Ministar izdaje podzakonski akt o dokumentovanim troškovima koji nastaju iz carinske procene ili ponovne procene.</p>
---	--	---

<p>7. Shpenzimet, përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit që lidhen me lizingjet operuese dhe lizingjet financiare, raportohen në mënyrën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>8. Nuk lejohet si zbritje për shpenzimet përveç atyre shpenzimeve të dokumentuara në mënyrën e kërkuar me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p>7. Expenses, including depreciation expenses, related to operating leasing and financial leasing shall be reported in the manner prescribed in a sub-legal act to be issued by the Minister.</p> <p>8. No deduction shall be allowed for any expense unless those documented in the manner required by a sub-legal act issued by the Minister</p>	<p>7. Troškovi, uključujući i troškove obezvređenja koji se odnose na operativne i finansijske lizinge, prijavljuju se na način utvrđen podzakonskim aktom kojeg izdaje ministar.</p> <p>8. Neće biti priznati kao odbijanje za troškove, osim onih koji su dokumentovani na zahtevani način podzakonskim aktom kojeg izdaje ministar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Deductions allowed for public interest activities</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Dozvoljena odbijanja za aktivnosti od javnog interesa</p>
<p>1. Kontributet e dhëna, nga tatimpaguesit që mbajnë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5 të nenit 35 të këtij ligji, në formë të donacionit dhe sponsorisimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij ligji konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut.</p> <p>2. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'i bëhet:</p>	<p>1. Contributions made by taxpayers who keep the books and records pursuant to paragraph 5 of Article 35 of the Law, in the form of a donation and sponsorship for humanitarian, health, education, religious, scientific, cultural, environmental protection and sports purposes are considered as contribution paid for public interest and are allowed as expenditures up to a maximum of ten percent (10%) of taxable income computed before the charitable contributions are deducted.</p> <p>2. An allowable contribution under paragraph.1 of this Article must be made to:</p>	<p>1. Izdaci plaćeni od poreskih obveznika koji vode knjige i evidencije, prema stavu 5. člana 35. ovog zakona, u obliku donacije ili sponzorstva za humanitarne, zdravstvene, edukativno-obrazovne, verske, naučne, i kulturne svrhe, za zaštitu okoline i sport, prema ovom zakonu smatraju se kao dati izdaci od javnog interesa i priznaju se kao troškovi do najviše deset odsto (10%) oporezivih prihoda izračunatih pre nego što je odbijen ovaj izdatak.</p> <p>2. Dozvoljeni izdaci prema stavu 1. ovog člana, trebaju se omogućiti:</p>

<p>2.1. një organizate të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi mbi themelimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare që ka pranuar dhe mbajtur statusin e beneficuar publik;</p> <p>2.2. çdo organizate tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen aktivitete me interes publik, siç janë:</p> <p>2.2.1. institucionet shëndetësore;</p> <p>2.2.2. institucionet edukativo-arsimore;</p> <p>2.2.3. organizatat për mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>2.2.4. institucionet fetare;</p> <p>2.2.5. institucionet që përkujdesen për persona me nevoja të veçanta apo për persona të moshuar;</p> <p>2.2.6. jetimoret; dhe</p> <p>2.2.7. institucionet në përkrahje të shkencës, kulturës, sportit apo të arteve.</p> <p>3. Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e afërm me donatorin.</p>	<p>2.1. An organization registered under relevant applicable legislation on the Establishment and Operation of Non-Governmental Organizations that has received and maintained public benefit status;</p> <p>2.2. Any other organizations that directly perform activities in the public interest, such as:</p> <p>2.2.1. Medical institutions;</p> <p>2.2.2. Educational institutions;</p> <p>2.2.3. Organizations to protect the environment;</p> <p>2.2.4. Religious institutions;</p> <p>2.2.5. Institutions that care for disabled or elderly persons;</p> <p>2.2.6. Orphanages; and</p> <p>2.2.7. Institutions that promote science, culture, sports or arts.</p> <p>3. An allowable deduction shall not include a contribution that directly, or indirectly, benefits the donor or related persons of the donor.</p>	<p>2.1. organizaciji registrovanoj prema važećem relevantnom zakonodavstvu o osnivanju i funkcionisanju nevladinih organizacija na Kosovu koja je dobila i ima javni beneficiran status;</p> <p>2.2. bilo kojoj drugoj organizaciji koja neposredno obavlja aktivnosti od javnog interesa, kao što su:</p> <p>2.2.1. zdravstvene institucije;</p> <p>2.2.2. edukativno-obrazovne ustanove;</p> <p>2.2.3. organizacije za zaštitu životne sredine;</p> <p>2.2.4. verske ustanove;</p> <p>2.2.5. institucije za staranje o hendikepiranim i starim licima;</p> <p>2.2.6. sirotišta; i</p> <p>2.2.7. institucije koje promovišu nauku, kulturu, sport ili umetnost.</p> <p>3. Dozvoljena odbijanja ne obuhvataju izdatke od kojih posredno ili neposredno imaju korist donatori ili lica povezana sa donatorom.</p>
---	---	--

<p>4. Secili tatimpagues që kërkon zbritje të lejueshme duhet t'i paraqesë ATK-së dëftesën e pagesës për një zbritje të tillë.</p> <p>5. Përveç zbritjes së lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesit që do të kontribuojnë në fusha të caktuara, do të kenë një lejim special deri në dhjetë përqind (10%) nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë.</p> <p>6. Për zbatimin e këtij neni Ministri nxjerr akt nënligjor.</p>	<p>4. Any taxpayer who claims an allowable deduction must submit a receipt in respect of such deduction to the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>5. In addition to the deduction allowed under paragraph 1 of this Article, taxpayers who contribute to certain areas will have a special deduction allowed of up to ten percent (10%) if provided for by specific laws in Kosovo</p> <p>6. The Minister shall issue a sub-legal act for implementation of this Article.</p>	<p>4. Bilo koji poreski obveznik koji zahteva dozvoljena odbijanje mora da podnosi u PAK-u potvrdu o uplati za takav odbitak.</p> <p>5. Pored dozvoljenog odbijanja prema stavu 1. ovog člana, poreski obveznici koji će doprineti u određenim oblastima, imaće specijalan odbijanje od deset odsto (10%) ako se to predviđa posebnim zakonima na Kosovu.</p> <p>6. Za sprovođenje ovog člana ministar izdaje podzakonski akt.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promociionit ekonomik</p> <p>1. Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzimet me karakter të përgjithshëm që një person afarist bënë për prezantimin dinjitoz të tij në marrëdhënie me partnerët apo institucionet e tjera, si: organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përrurimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me aktivitetin e biznesit.</p> <p>2. Shpenzimet e përfaqësimit janë të kufizuara në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Representation, advertisement and economic promotion expenses</p> <p>1. The representation expenses include expenses of general character that a businessperson incurred for the purpose of a dignified presentation in relation to its partners or other institutions, such as: organizing meetings, presenting new projects, inaugurating new lines or products, treats and hosting related to the business activity.</p> <p>2. Representation expense is limited to one percent (1%) of gross annual income.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Troškovi reprezentacije, reklame i ekonomske propagande</p> <p>1. U troškovima reprezentacije obuhvataju se troškovi opšteg karaktera koje poslovno lice stvara za dostojanstvenu prezentaciju u odnosima sa drugim partnerima ili organizacijama, kao što su: organizovanje sastanaka, predstavljanje novih projekata, inauguracija novih linija ili proizvoda, čašćenje i prijemi-dočeci koji se odnose na poslovne aktivnosti.</p> <p>2. Troškovi reprezentacije su ograničeni na jedan odsto (1%) godišnjih bruto prihoda.</p>

<p>3. Shpenzimet e reklamës dhe promovimit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billboardat, reklamata tranzite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.</p>	<p>3. Advertising and promotion expenses conducted in different information outlets such as: television, radio, newspapers, magazines, direct advertisement, internet, posters, leaflets, billboards, transit advertisements and similar, are fully deductible expenditures for tax purposes.</p>	<p>3. Troškovi reklame i propagande stvaraju se putem različitih oblika informisanja, kao što su: televizija, radio, novine, magazini, direktna reklama, internet, poster, plakati, bilbordi, tranzitne reklame i druge slične, predstavljaju troškove u potpunosti odbijene sa poreske svrhe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Shpenzimet e Borxhit të keq</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Bad Debts expenses</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Troškovi lošeg duga</p>
<p>1. Një borxh i keq konsiderohet shpenzim nëse i plotëson kushtet vijuese:</p> <p>1.1 pagesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pambledhshëm duke iniciuar procedurat në organet gjyqësore;</p> <p>1.2. borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë muaj nga afati i obligimit për pagesë;</p> <p>1.3. shuma që korrespondon me borxhin më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;</p> <p>1.4. nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;</p> <p>1.5. ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:</p>	<p>1. A bad debt shall be considered an expense if it meets these conditions:</p> <p>1.1. The payment has not been fully or partially received and is considered as uncollectable, thereby initiating procedures before judicial bodies;</p> <p>1.2. the debt has exceeded the term for at least six months;</p> <p>1.3. the amount corresponding to the debt has been earlier included as income in the accounting books;</p> <p>1.4.; There is no dispute of the legal validity of the debt;</p> <p>1.5. There is adequate evidence of substantial attempts made by the taxpayer to collect the debt, including any applicable actions to maximize collection of the debt, such as:</p>	<p>1. Loš dug smatra se troškom ako ispunjava sledeće uslove:</p> <p>1.1. uplata nije primljena u potpunosti ili delimično i proglašena je neizmirljvom pokretanjem postupka u sudskim organima;</p> <p>1.2. dug je prekoračio najmanje šest meseci rok za plaćanje;</p> <p>1.3. iznos koji odgovara dugu ranije je obuhvaćen u računovodstvenim knjigama kao prihod;</p> <p>1.4. ne postoji spor o pravnoj valjanosti duga;</p> <p>1.5. postoje dovoljne evidencije da su učinjeni supstancijalni naponi za naplatu duga, uključujući bilo kakvu primenjivu aktivnost u cilju povećanja naplate duga, kao što su:</p>

<p>1.5.1. tatimpaguesi ka balancuar çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;</p> <p>1.5.2. korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin;</p> <p>1.5.3. kërkesa është dorëzuar mbi mjetet e falimentimit/likuidimit, nëse është e aplikueshme dhe shuma që merret është përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori, përmbaruesi, si dhe deri në shkallën sa janë marrë nga falimentimi, janë aplikuar në borxhin e pashlyer.</p> <p>1.6. tatimpaguesi lëshon një faturë për shumën e paarkëtuar ku shkruhen fjalët “Borxh i keq”, si dhe numri i faturës, me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar të ardhurën dhe blerësit për të zvogëluar shpenzimin (koston).</p> <p>1.7 Për shumën deri në pesëqind (500€) euro të trajtuar si borxh të keq nuk kërkohet iniciimi i procedurave në organet gjyqësore.</p> <p>2. Zbritjet e borxhit të keq janë të kufizuara në pjesën e pambuluar të borxhit. Çdo borxh i keq i zbritur si një shpenzim dhe pastaj është mbledhur, përfshihet në të</p>	<p>1.5.1. taxpayer has balanced any undisputed against the bad debt;</p> <p>1.5.2. correspondence and contacts attempting to collect the debt;</p> <p>1.5.3. the claim was filed in a bankruptcy/liquidation proceeding, if applicable, and the amount to be received has reasonably been determined by the administrator/executor, and to the extent that money received from bankruptcy has been applied to the outstanding debt.</p> <p>1.6. the taxpayer issues an invoice on the uncollected amount containing the phrase “Bad Debt” and the number of the invoice, to which the debt is related, whereby the invoice can be used by the seller to reduce the income and the purchaser to reduce the expenses (costs).</p> <p>1.7 For the amount up to five hundred (500) Euros, treated as bad debt, it is not required to initiate judicial procedures.</p> <p>2. Bad debt deductions are limited to the non-recovered portion of the debt. Any bad debt deducted as an expense and then subsequently collected shall be included in</p>	<p>1.5.1. poreski obveznik je balansirao svaki nesporni dug u odnosu na loš dug;</p> <p>1.5.2. korespondencija i kontakti u pokušaju naplate duga;</p> <p>1.5.3. zahtev je podnet na sredstva stečaja/likvidacije, ako je primenljivo, i iznos koji će se uzeti određen je na razuman način od administratora, izvršioca, do stepena koliko su uzeti od stečaja, primenjeni su na neizmiren dug.</p> <p>1.6. poreski obveznik izdaje fakturu za nenaplaćeni iznos na kojoj piše reči „Loš dug“, kao i broj fakture, koja služi prodavcu da smanji prihode i kupcu da smanji troškove;</p> <p>1.7. za iznos do petsto (500 €) koji se smatra lošim dugom, ne zahteva se pokretanje postupaka u sudskim organima.</p> <p>2. Smanjenje lošeg duga su ograničena na nepokriveni deo duga. Svaki loš dug smanjen kao trošak i koji je nakon toga je</p>
---	---	--

<p>ardhurat e tatimpaguesit në kohën e mbledhjes.</p> <p>3. Shuma e paarkëtuar nuk konsiderohet borxh i keq nëse:</p> <p>3.1. transaksionet me të njëjtin borxhli janë përsëritur pas shpalljes së borxhit të keq, me përjashtim të shërbimeve publike;</p> <p>3.2. borxhi i keq është ndërmjet palëve të lidhura;</p> <p>3.3. nuk ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të mbledhur borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit;</p> <p>3.4. procedurat për ta shpallur borxh të keq nuk janë iniciuar brenda 24 muajve nga data e obligimit për pagesë.</p> <p>4. Ministri nxjerr akt nënligjor për të përshkruar kërkesat për zbritjen e borxhit të keq sikur që është paraparë me këtë nen.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë dhe provizionet teknike dhe matematike</p> <p>1. Provizionet për humbjet e pritura nuk lejohen si shpenzime të zbritshme në</p>	<p>the taxpayer income at the time of collection.</p> <p>3. The uncollected amount shall not be considered as bad debt, if:</p> <p>3.1. If transaction with the same debtor have been repeated after the proclamation of bad debt, with the exclusion of public services;</p> <p>3.2. bad debt exists between related parties;</p> <p>3.3. There is no sufficient evidence proving that substantial efforts have been done to collect the debt, including all applicable actions to maximise debt collection;</p> <p>3.4. the procedures for declaring bad debt were not initiated within 24 months from the date of the payment obligation.</p> <p>4. The Minister shall issue a sub-legal act to describe the requirements for the deduction of bad debt as foreseen in this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Provisions for expected losses on loans, technical and mathematical provisions</p> <p>1. Provisions for expected losses are not allowed as deductible expenses in the</p>	<p>naplaćen, obuhvata se u prihode poreskog obveznika za vreme naplate.</p> <p>3. Nenaplaćen iznos se ne smatra lošim dugom ako:</p> <p>3.1. transakcije sa istim dužnikom su ponovljene nakon proglašenja lošeg duga, izuzev javnih usluga;</p> <p>3.2. loš dug između povezanih lica;</p> <p>3.3. nema dovoljnih evidencija da li su učinjeni supstancijalni naponi za naplatu duga, uključujući bilo kakvu primenjivu radnju za povećanje naplate duga.</p> <p>3.4. procedure za proglašenje lošeg duga nisu pokrenute u roku od 24 meseca od dana plaćanja obaveze.</p> <p>4. Ministar izdaje podzakonski akt za opisivanje zahteva za smanjenje lošeg duga kao što je utvrđeno ovim članom.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Provizije za očekivane gubitke od kredita, tehničkih i matematičkih provizija</p> <p>1. Provizije za očekivane gubitke nisu dozvoljeni kao odbitni troškovi tokom</p>
---	---	---

<p>përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, përveç rasteve të parapara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.</p> <p>2. Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të licencuara nga BQK, për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për humbjet e pritura nga kreditë, në shumën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri, e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejueshme nga BQK.</p> <p>3. Institucionet financiare të sigurimeve dhe ri-sigurimeve të licencuara nga BQK, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për rezervat teknike dhe matematike, në shumën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri, e cila nuk duhet të tejkaloj shumën maksimale të përcaktuar me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK.</p> <p>4. Pas njohjes së provizioneve sipas paragrafit 2 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga mbledhja e kredive të provizionuara, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.</p>	<p>determination of taxable income, except as provided in paragraphs 2 and 3 of this Article.</p> <p>2. Banks, microfinance institutions and non-bank financial institutions licensed by the CBK for the determination of taxable income shall be entitled to recognize deductible expenses the provision for expected losses from loans, in the amount determined by a sub-legal act issued by the Minister, who shall not exceed the maximum allowable amount by CBK.</p> <p>3. Financial insurance and reinsurance institutions licensed by the CBK, in determining the taxable income, have the right to recognize the deductible expenses for technical and mathematical reserves, in the amount determined by sub-legal act issued by the Minister, which should not exceed the maximum amount determined by the Law on Insurance and sub-legal acts issued by the CBK.</p> <p>4. After recognizing the provisions under paragraph 2 of this Article, any amount deducted from the collection of provisioned loans shall be included in taxable income, and any amount increased up to the allowable amount shall be recognized as a deductible expense.</p>	<p>utvrđivanja oporezivih prihoda osim slučajeva predviđenih u stavovima 2. i 3. ovog člana.</p> <p>2. Banke, mikrofinansijske institucije i nebankovne finansijske institucije licencirane od CBK za utvrđivanje oporezivog prihoda, imaju pravo da prepoznaju odbitni trošak, provizije za očekivane kreditne gubitke u iznosu utvrđenim propisima izdate od Ministra, iznos koji ne smije prekoračiti maksimalni dozvoljeni iznos od CBK-a.</p> <p>3. Finansijske institucije osiguranja i re-osiguranja licencirane od CBK, u utvrđivanju poreskog prihoda imaju pravo da prepoznaju odbitni trošak provizije za tehničke i matematičke rezerve, u iznosu propisan podzakonskim aktima izdatim od ministra, iznos koji ne smije da prelazi maksimalni iznos utvrđen Zakonom o osiguranju i podzakonskim aktima koje je izdala CBK.</p> <p>4. Nakon priznavanja provizija iz stava 2. ovog člana, bilo koji smanjeni iznos od prikupljenih kredita, uključuje se u oporezivi prihod, a dok bilo koji drugi iznos povećan u proviziji do dozvoljene količine, priznat će se kao odbitni trošak.</p>
---	--	---

<p>5. Pas njohjes së provizioneve teknike dhe matematike sipas paragrafit 3 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga provizionet, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.</p> <p>6. Në rast se BQK kërkon korrigjim të provizioneve të deklaruara sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, ndryshimet e tilla duhet të rregullohen në deklaratë tatimore.</p> <p>7. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>5. After the recognition of technical and mathematical provisions under paragraph 3 of this Article, any amount deducted from provisions is included in taxable income, and any amount increased in provision up to the allowable amount is recognized as deductible expense.</p> <p>6. If the CBK requires correction of the provisions declared under paragraphs 2 and 3 of this article, such changes shall be regulated in the tax declaration.</p> <p>7. The Minister shall issue a sub-legal act for the implementation of this Article.</p>	<p>5. Nakon prepoznavanja tehničkih i matematičkih provizija iz stava 3. ovog člana, bilo koji iznos smanjen od prikupljanja provizioniranih kredita, uključuje se u oporezivi prihod, dok bilo koji iznos povećan u proviziji do dozvoljenog iznosa priznaje se kao odbitni trošak.</p> <p>6. Ako CBK zahteva ispravke provizija izjavljene prema stavu 2. i 3. ovog člana, takve promene će se regulisati u poreskoj deklaraciji.</p> <p>7. Ministar izdaje podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Pagesat për personat e lidhur</p> <p>1. Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p> <p>2. Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Payments to Related Persons</p> <p>1. Compensation or emoluments paid to a related person shall be allowed as an expense in an amount equal to the open market value.</p> <p>2. Interest, rent, and other expenses paid to related persons shall be allowed as an expense in an amount equal to the minimum actual payment or the open market value.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Isplate povezanim licima</p> <p>1. Naknada ili plate isplaćene povezanim licima priznaju se kao troškovi u iznosu jednakom otvorenoj tržišnoj vrednosti.</p> <p>2. Kamata, zakup i drugi troškovi plaćeni povezanim licima priznaju se kao troškovi u iznosu jednakom otvorenoj tržišnoj vrednosti.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 16 Zhvlerësimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Depreciation</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Obezvredenje</p>
<p>1. Shpenzimet për pronën e prekshme, përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohen për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, kompensohen me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.</p> <p>2. Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.</p> <p>3. E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas këtij neni, caktohet në një rën prej kategorive vijuese:</p> <p>3.1. Kategoria 1 - ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;</p> <p>3.2. Kategoria 2 - automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mboilet</p>	<p>1. Expenditures on tangible property, other than expenditures for land, works of art, and other property which are not subject to wear, owned by the taxpayer and used for the taxpayer's economic activity, shall be compensated over time by depreciation deductions in the manner prescribed by this Article.</p> <p>2. Expenditures on improvements to leaseholds used for the taxpayer's economic activity shall be compensated through depreciation deductions calculated using the straight-line method with a period equal to the life of the leasehold.</p> <p>3. All tangible property of the taxpayer that is subject to depreciation under this Article shall be placed in one of the following categories:</p> <p>3.1 Category 1: Buildings and other constructed structures;</p> <p>3.2 Category 2: Automobiles and light trucks, heavy transport vehicles, earth moving equipment, bulldozers, scrapers and other heavy vehicles, computers, peripherals and other data processing equipment, office furniture and office equipment, instruments, sundries and</p>	<p>1. Troškovi u vezi sa materijalnom imovinom, osim troškove za zemljište, umetnička dela, i za drugu imovinu koja ne podleže potrošnji, koju poseduje poreski obveznik i koja se koristi za poslovne aktivnosti poreskog obveznika, nadoknađuje se postepeno pomoću odbitaka za obezvređenje na način koji je utvrđen ovim članom.</p> <p>2. Troškovi poboljšanja imovine pod zakup koja se koristi za poslovne aktivnosti poreskog obveznika, nadoknađuju se pomoću odbitaka za obezvređenje obračunatim linearskom metodom za period jednak roku trajanja zakupa imovine.</p> <p>3. Sva materijalna imovina poreskog obveznika koja podleže obezvređenju prema ovom članu spada u jednoj od sledećih kategorija:</p> <p>3.1. Kategorija 1 - zgrade i druge građevinske strukture;</p> <p>3.2. Kategorija 2 - automobili i laki kamioni, vozila za teški transport, oprema za prevoz zemljišta, buldožeri, kopači zemlje i druga teška vozila, računari, prateća računarska oprema i druga prema za obradu podataka, kancelarijski nameštaj i kancelarijska</p>

